


DPK/DMP	03-530/2013
02	20.02.2013



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
 SUDSKI SAVET KOSOVA
 KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Regj.I.nr.7557 /2012

Gjykata Themelore Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni i Kundërvajtjes, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Nexhat Dedia nga fsh.Shupkocf komuna e Mitrovicës , për shkak të kundërvajtjes nga neni 9 , lidhur me nenet 5 dhe 6 par. 1 pika 1,2 , e sanksionuar sipas nenit 17.par.1. pika 1,1 të Ligjit Për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin,Prejardhjen dhe kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë /Ligji nr.04/L-50/,e në bazë të nenit 10,73,74,195 dhe 199 të Ligjit për Kundërvajtjet,me datën 11.02.2013 ,bjen këtë:

A K T V E N D I M

I pandehuri:Nexhat Dedia i lindur me datën 24.07.1972 në Mitrovicë ,Këshilltar në Asamblenë Komunale në Mitrovicë,i martuar,prind i 3 /tre/ fëmijëve ,teknik i ndërtimtarisë,i gjendjes së mesme ekonomike , gjer më tani i padënuar për kundërvajtje,me vendbanim të përhershëm në fsh.Shupkocf Komuna e Mitrovicës

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse si zyrtarë i lartë publik ,Këshilltar në Asamblenë Komunale në Mitrovicë nuk e ka bërë deklarin e rregullt te gjendjes së pasurisë në Agjencinë kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor deri me 31.03.2012.

- me ç`rast ka bërë kundërvajtje nga neni 8 par.1 lidhur me nenet 5 dhe 6.par.1 pika 1,2 e sanksionuar me nenin 17,parag.1 pika 1,1 të Ligjit Për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin,Prejardhjen dhe kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë /Ligji nr.04/L-50/,andaj në bazë të dispozitave të të njejtit ligj,e në pajtim me dispozitën e nenit 10 të Ligjit për Kundërvajtjet, i shqiptohet:

Q O R T I M

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

Aktvendimi iu dërgohet : të pandehurit dhe kerkesë-dhënësit.

A r s y e t i m

Agjencioni kundër Korrupsionit në Prishtinë,me kërkesën nr. 01-2528/12 të datës 24.07.2012 ,ka propozuar që kundër të pandehurit Nexhat Dedia të fillohet procedura kundërvajtëse për shkak të kundërvajtjes nga neni 8 par.1 lidhur me nenet 5 dhe 6 par. 1 pika 1,2 , e sanksionuar sipas nenit 17.par.1. pika 1,1 të Ligjit Për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin,Prejardhjen dhe kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë /Ligji nr.04/L-50/,të shpallet përgjegjës dhe dënohet sipas ligjit.

I pandehuri në procesverbal pranë kësaj gjykate deklaroi ;Është i vërtet fakti se që nga viti 2010 jam anëtar i Asamblesë Komunale në Mitrovicë dhe se në muajin mars/2012 nga zyrtarja Merita Preteni e kam pranuar formularin për deklarin e pasurisë dhe të njejtin të plotësuar e kam dorëzuar tek zyrtari Fitim Rama si person kontaktues me Agjencionin.

Me qëllim të vërtetimit dhe konstatimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjatë procedurës është dëgjuar edhe dëshmitari Fitim Rama ,zyrtar juridik i shërbimeve publike në Mitrovicë ,njëherit person kontaktues me Agjencinë Kundër Korrupsionit i cili deklaroi, se në momentin e marrjes së formularëve prej Agjencionit, menjëherë i ka njoftuar të gjithë zyrtarët e lartë publik , në mes tyre edhe z.Nexhat Dedia i cili pas plotësimit të të njejtit, formularët e plotësuar mi ka dorëzuar personalisht dhe të cilin e kam përcjell në agjencion ku me rastin e dorëzimit e kam marrë vërtetimin mbi dorëzimin në agjencion të cilin ia kam kthyer z.Nexhat Dedia dhe se në rastin konkret është në pyetje ndonjë lëshim administrativ.

Poashtu është degjuar përfaqësuesi i Agjencionit Antikorrupsion z.Agron Behrami i cili deklaroi:se i ka informuar të gjithë personat kontaktues nëpër komuna për informimin e të gjithë zyrtarëve të lartë publik të cilët janë të obliguar që t'i plotësojnë dhe dorëzojnë në agjencion formularët mbi deklarimin e pasurisë për vitin 2012,në mes tyre edhe në rastin konkret për z.Nexhat Dedia, por i njejtë në afatin ligjor deri me datën 31.03.2012 nuk e ka bërë një gjë të tillë. Pas informimit lidhur me deklaratën e të pandehurit dhe personit kontaktues lidhur me faktin se në mënyrë bindëse deklaruan se i kanë dorëzuar formularët në agjencion,i njejtë mori për obligim që ta verifikoi këtë në agjencion.Pas verifikimit në Agjencion i njejtë me emal e informoi gjykatën se i pandehuri Nexhat Dedia me datën 02.04.2012 e ka dorëzuar formularin në Agjencion gjë e cila vërtetohet në bazë të Vërtetimit nr.03/3296/12 të datës 02.04.2012.

Me rastin e caktimit të denimit ndaj të pandehurit Gjykata mori si rrethanë lehtësuese ,se i pandehuri nuk i ka ikur obligimit për deklarim të pasurisë dhe se obligimin e ka përmbushur vetëm dy dite pas afatit ligjor me 02.04.2012, andaj në bazë të nenit 10 të Ligjit mbi kundërvajtjet iu shqiptua Qortimi pasi gjyqtarja është e mendimit se edhe me shqiptimin e Qortimit ndaj të pandehurit do të arrihet efekti dhe se i njejtë nuk do ta përsërisë kundërvajtjen. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kundërvajtëse është bërë në bazë të nenit 109 al. 2 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 8 ditësh prej ditës së marrjes së aktvendimit Gjykatës së Apelit Prishtinë-Departamenti të Përgjithshëm-Divizionit të Kundërvajtjes , përmes kësaj Gjykate.

U vendos në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni i Kundërvajtjes me datën 11.02.2013 Regj.I.nr.7557/2012.

GJYQTARJA

Florije Syla

Fl Syla